VENDIM
Nr.736, datë 7.11.2007

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS LEVAN-VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë, në shumën prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) eurosh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha